



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	13.12.2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSSEL	7448/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1365/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bektëshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.1365/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar kundër

Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", në mbështetje të dispozitave të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.1365/2023 e datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 06.04.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër reference: RN00011404 për grupin "Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Proklitike", respektivisht për pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", ku afati për aplikim ka qenë nga data 27.04.2023 deri më datë 06.05.2023.

Sipas shkresave të lëndës në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Vendimit me Nr.66/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi të zotësisë për të vepruar.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si shkallë e dytë, ndërsa ky i fundit me

Vendimin me Nr.09/2023 të datës 14.06.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se aplikacioni nuk ka qenë i kompletuar.

Ankuesi, më datë 01.11.2023 përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë më numër protokoll 6800/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se ka pranuar njoftimin e datës 31.10.2023 për rezultatet përfundimtare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa me datë 14.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** (në tekstin e mëtejme: Kolegji) ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokoll 6800/2023 të datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.09/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.66/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Pasqyrën e dokumenteve të ngarkuara në SIMBNJ; Emailin e datës 07.06.2023 nga ankuesi për SIMBNJ, Sh.H, A.K dhe B.C; Vërtetimin e datës 03.08.2023 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Gjilan; Ankesën e datës 07.06.2023 të ankuesit; Përgjigjen në ankesë; Konkursin me Nr.Referenc: RN00011404 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Proklitike respektivisht për pozitën *Zyrtar i Misionit Diplomatik*; Vendimin me Nr. 05/142 të datës 10.05.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 05.06.2023, 14.06.2023 dhe 30.06.2023; Aplikacionin e ankuesit i datës 05.05.2023; Aplikacionin e kandidatit M.V të datës 04.05.2023; Aplikacionin e kandidatit Y.S të datës 27.04.2023; Aplikacionin e kandidatit S.B të datës 03.05.2023; Aplikacionin e kandidatit S.S të datës 04.05.2023; Aplikacionin e kandidatit A.H të datës 06.05.2023; Aplikacionin e kandidatit M.S të datës 01.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas administrimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e pasafatshme, *sepse*:

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 14.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.09/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit kundër Vendimit me Nr.66/2023 të datës 05.06.2023, duke u njoftuar të njëjtin për mundësin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda 30 ditësh, pas publikimit të aktit përfundimtar të procedurës së rekrutimit. Rrjedhimisht, sipas provave materiale rezulton se më datë 30.06.2023 është publikuar njoftimi për kandidatët fitues, në bazë të vlerësimit përfundimtar të Komisionit të Pranimit, dhe se me publikimin e këtij njoftimi ankuesit i ka lindur e drejta e parashtrimit të ankesës.

Ankuesi, edhe përkundër faktit se ishte në dijeni për Njoftimin e datës 30.06.2023, lidhur me kandidatët fitues në bazë të vlerësimit përfundimtar të Komisionit të Pranimit, i njëjti nuk ka parashtruar ankesë në afatin ligjor prej 30 ditësh, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data



kur është njoftuar për aktin administrativ", andaj, bazuar si me sipër Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 01.11.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pas afatshme, ngase nuk është parashtruar brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur është publikuar njoftimi për kandidatet e suksesshëm, me datë 30.06.2023, dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike:* Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda: A.nr.1365/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

